

Udhëzues i thjeshtë për pre-eklampsinë

Ndihem mirë. Pse duhet të shkoj të takohem rregullisht me maminë?

Mamia juaj:

- Do kujdeset për shëndetin tuaj dhe të fëmijës.
- Do të njihet me ju, në mënyrë që të mund të dallojë ndryshime të tilla që tregojnë se keni rrezik të prekeni nga sëmundje të tilla si pre-eklampsia.

Çfarë është pre-eklampsia?

- Pre-eklampsia është një sëmundje që shfaqet gjatë shtatzanisë.
- Zakonisht është e lehtë.
- Ndonjëherë mund të jetë serioze.
- Mund t'ju prekë ju ose fëmijën.

Pre-eklampsia më parë është quajtur toksemi.

Çfarë e keqe na vjen nga kjo sëmundje, mua dhe fëmijës?

- Pre-eklampsia mund t'ju rritë tensionin arterial dhe të shkaktojë probleme të tjera.
- Pre-eklampsia mund të bëjë që fëmijës të mos i shkojë ushqim dhe oksigjen i mjaftueshëm.
- Fëmija mund të rritet më ngadalë dhe të shfaqë probleme të tjera.

A ka rrezik që unë ta kem këtë sëmundje?

Rreziku vjen e shtohet në qoftë se:

- Kjo është fëmija e parë që keni.
- Keni në familje të afërm (nënë ose motër) që kanë pasur pre-eklampsi.
- Jeni 40 vjeç ose më e moshuar.
- Keni vuajtur më parë nga tensioni i lartë arterial.
- Vuani nga veshkat ose nga diabeti.
- Prisni t'ju lindin binjakë, trinjakë ose më shumë.
- Keni pasur pre-eklampsi më parë.
- Keni një BMI (tregues të masës trupore) prej 35 ose më shumë.
- Kanë kaluar 10 vjet ose më shumë që kur lindët fëmijë për herë të fundit.
- Vuani nga sëmundje të tilla si tension i lartë arterial, sëmundje veshkash, diabet, ose sindromi antifosfolipid.

Si ta marr vesh nëse e kam apo jo?

Pre-eklampsia shfaqet gjatë gjysmës së dytë të shtatzanisë.

Mund të shfaqet me:

- Dhimbje të forta koke që zgjatin shumë.
- Turbullim i shikimit, njolla drite ose njolla të tjera në fushëpamje.
- Dhimbje e fortë poshtë brinjëve, sidomos në anën e djathtë.

Të gjitha këto mund të jenë shenja të pre-eklampsisë.

Çfarë mund të bëjë mamia për të më ndihmuar?

- Do t'ju matë tensionin rregullisht.
- Do t'ju analizojë urinën, për të parë nëse ka proteina.

Tensioni i lartë arterial dhe proteinat në urinë mund të jenë shenja të pre-eklampsisë.

Çfarë mund të më ndihmojë mua ose fëmijën tim, në rast se kam pre-eklampsi?

- Zbulimi i hershëm i pre-eklampsisë do ta bëjë më të lehtë që të mbrohet shëndeti juaj dhe i fëmijës suaj.
- Mund t'ju jepet mjekim për të ulur tensionin e lartë arterial.
- Mund t'ju kërkohet të rrini në spital, në mënyrë që mjekët dhe mamitë t'ju ndjekin nga afër, ju dhe fëmijën.
- Fëmija mund të lindë më herët.

Pasi të lindë fëmija, shenjat e pre-eklampsisë do të zhduken shpejt.

Po të më shfaqet pre-eklampsia, vallë e kam fajin unë vetë?

- Jo. Ju s'mund të bëni asgjë për ta parandaluar.
- Tensioni i lartë arterial në pre-eklampsi nuk shkaktohet nga shqetësimi ose stresi, ose ngaqë vazhdoni punën kur jeni shtatzanë.

Për informacione të mëtejshme, na shkruani në adresën:

Action on Pre-Eclampsia

84-88 Pinner Road,

Harrow, Middlesex HA1 4HZ

e-mail: info@apec.org.uk

Bamirësi e regjistruar no. 1013557

© APEC 2004-07-12

www.apec.org.uk

"Action on Pre-Eclampsia" është një shoqatë bamirëse mbarëkombëtare që ndihmon dhe mbështet gratë me pre-eklampsi. "Action on Pre-Eclampsia" organizon kurse për mami dhe mjekë. "Action on Pre-Eclampsia" mund t'ju ndihmojë duke ju informuar, ose duke ju ofruar mbështetje nëpërmjet linjës telefonike të ndihmës.

Numri i linjës telefonike të ndihmës: 020 8427 4217

Mos harroni

Të vini të vizitoheni

- Të miqësoheni me maminë tuaj

Të informoheni

- Për pre-eklampsinë

Të mbroni veten

- Numri i telefonit të mamisë:
-